

Z.Enton Sadiku

është Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Sistemeve të Komunikimit në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK). Gjatë ushtrimit të funksionit të Tij, ka kryer; hartimin e politikave për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare; mbikqyrjen dhe drejtimin e shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit të klasifikuar të NATO dhe BE midis RSH dhe këtyre organizatave; mbikqyrjen e masave për sigurimin e informacionit të klasifikuar në institucionet shtetërore; drejtimin dhe ndjekjen e procesit të akreditimit të sigurisë për sistemet e komunikimit në të cilat trajtohet informacion i klasifikuar: përfaqësimin e DSIK në marrëdhëniet me Zyrën e Sigurisë së NATO dhe në Komitetin e Sigurisë së NATO për çështje të ndryshme të sigurisë si, trajtimi i problematikave dhe çështjeve të rëndësishme të sigurisë të ngritura nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO, Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC), Vendet Anëtare, Komiteti Ushtarak i NATO ose organizmat civile dhe ushtarake të NATO, si; kërcënimet e sigurisë ndaj NATO dhe vendeve anëtare të saj, rishikimi i politikës së sigurisë së NATO, lufta kundër terrorizmit, kërcënimet hibride, masat për mbrojtjen kibernetike, evidentimi i disa prej formave dhe metodave të veprimtarisë së Shërbimeve Sekrete, etj.

Enton Sadiku është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Ai ka përfunduar studimet Postmaster mbi Sigurinë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, pranë universitetit privat, “Albanian University”, Tiranë, dhe pranë Akademisë Diplomatike Shqiptare për Marrëdhëniet Ndërkombëtare dhe Diplomaci. Njëkohësisht është trajnuar nga Projekti i financuar nga BE për zbatimin e metodologjisë së re për hartimin dhe monitorimin e instrumentave kryesor për planifikimin dhe koordinimin e reformave të lidhura me BE, në kuadër të përgatitjeve për procesin e negociatave, si dhe për Zvillimin e Planifikimit Strategjik të Sigurisë “Strategic Planning for Security and Development”, organizuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe në bashkëpunim me Cranfield University, etj.

Enton Sadiku gëzon titullin “Avokat”, si dhe zotëron gjuhën angleze dhe italiane.